

## **“BUXHETIMI ME PJESEMARRJE” NE BASHKINE ELBASAN**

Buxhetimi me Pjesemarrje synon te fuqizojë pjesemarrjen e qytetareve dhe te shoqerise civile ne qeverisjen vendore, ne menyre me specifike ne procesin e hartimit te buxhetit per investime. Ky proces perpiqet te zhvilloje nje sere instrumentash te cilat lidhin buxhetin me vendim-marrjen, bazuar ne konsultimet me publikun e gjere.

Impakti i deshiruar nga procesi i Buxhetimit me Pjesemarrje eshte tu siguroje qytetareve mundesine per te marre pjese ne proceset vendim-marrese te cilat kane te bejne me financimin e investimeve. Bashkepunimi mes qytetareve, organizatave jo-qeveritare, perfaqesuesve te sektorit te biznesit dhe te pushtetit vendor sjell si rezultat politika financiare me transparente, me te drejta dhe efektive.

Nepermjet ketij procesi arrihet nje effiçence me e larte ne shperndarjen e burimeve te kufizuara qe pushteti vendor ka ne dispozicion per te patur nje performance me te larte ne lidhje me sherbimet qe i ofrohen komunitetit qytetar.

Ky bashkepunim eshte i rendesishem edhe sepse ai mundeson pjesemarrjen aktive te komunitetit dhe forcon demokracine direkte.

Procesi i Buxhetimi me Pjesemarrje ne Bashkine Elbasan, me financim te Bankes Boterore, eshte konceptuar ne kuadrin e pergjithshem te programit EGUG II - “Per nje Qeverisje te Mire Urbane”, me ane te te cilit po hartohet Strategjia e Zhvillimit te Qytetit. Ne kete kuader, Buxhetimi me Pjesemarrje konsiderohet si nje mekanizem i cili do te siguroje zbatimin e Strategjise se Zhvillimit te Qytetit pergjate viteve, duke kombinuar objektivat afatgjate me ato afatshkurter persa i perket nevojës se qytetit per investime.

**Buxhetimi me Pjesemarrje eshte nje proces renditjeje prioritetesh dhe vendim-marrjeje i perbashket permes se cilit qytetaret dhe pushteti vendor vendosin bashkarisht ne lidhje me akordimin perfundimtar te investimeve publike.**

Objektivat kryesore te projektit jane si me poshte:

- Nxitja e pjesemarrjes qytetare, dhe ne vecanti e grupeve ne nevojë, ne procesin e vendim-marrjes
- Rritja e eficiency dhe efektivitetit te fondeve publike
- Mundesimi per zbatimin e objektiveve te shprehura ne Strategjine e Zhvillimit te Qytetit
- Fuqizimi i kapaciteteve vendore per organizimin dhe koordinimin e procesit te BP
- Rritja e transparencës ne lidhje me perdorimin e fondeve bashkiake

### **Vazhdimesia e Procesit**

Bashkia Elbasan eshte e angazhuar qe te alokoje cdo vit fonde per kryerjen e procesit te Buxhetimi me Pjesemarrje, duke ndare nje ze ne buxhetin e saj per kete proces. Per kete

eshte krijuar nje strukture te brendshme pergjegjese per buxhetimin me pjesemarrje. Kjo njesi do te angazhohet vazhdimisht me lehtesimin dhe koordinimin e aktiviteteve te BP si edhe eshte e trajnuar per kryerjen me lehtesi dhe sukses te Procesit.

### **Buxhetimit me Pjesmarrje ka kaluar neper disa faza.**

**Krijimi i bazes se mirekuptimit.** Njohja e stafit te Bashkise Elbasan me projektin e Buxhetimit me Pjesmarrje, nenshkrimi, prezantimi i tij dhe miratimi i ketij projekti ne Keshillin Bashkiak per vazhdimin e punes. Njekohesisht Keshilli Bashkiak u shpreh per vazhdimin e tij edhe ne vitet pasardhese duke e mbeshetur edhe nga ana financiare.

Per procesin u nenkontraktuan dy OJF lokale ne rolin e lehtesuesve, si edhe nje organizate studentore nga Universiteti Elbasanit. Pergjegjesite e te dy lehtesuesve lokal jane:

- Pergatitja e fushates se komunikimit per kete faze (postera, fletepalosje, etj. ku shpjegohet ne menyre te thjeshtuar buxheti bashkiak per vitin 2005. Ky informacion do te sigurohet nga grupi i punes ne bashki), identifikimi i grupeve ne nevoje dhe hartimi i nje plani pune per perfshirjen dhe perfaqesimin e tyre ne proces.
- Siguron pjesemarrje gjate procesit te informimit, nxjerrjes se prioriteteve dhe zgjedhjes se perfaqesuesve ne Komisionin e Buxhetimit me Pjesmarrje te cilat do te jene pjese e Projekt-Buxhetit.
- Ne bashkepunim me Bashkine organizon “Karvan”-it te prioriteteve, dokumenton me ane te fotografive Karvanin dhe takimet e Komisionit te BP.
- Marrin pjese aktive ne organizimin e mbledhjeve te Komisionit te BP.

### **Organizimi, trainimi kishte per qellim:**

- Trainim i stafit te OJF-ve dhe Bashkise. Duke qene se projekti aplikohet per here te pare ne Bashkine Elbasan, ishte e domozdoshme trainimi i stafit te Bashkise si dhe i stafit te OJF-ve ne rolin e lehtesuesve
- Ndarja e territorit ne 10 zona ku ne pese te tilla punoi nje OJF dhe ne pese te tjerat punoi tjetra.
- Ne te gjitha Zonat u realizua nje fushate e fuqishme sensibilizuese, si nepermjet medias, njoftimeve dere me dere, posterave, telefonit, etj. Per procesin e Buxhetimit me Pjesmarrje u pergatiten hartat e varferise, shume te domozdoshme per kete proces.

### **Cikli pare i Takimeve me Komunitetin:**

- Ne kete faze qytetaret e ftuar ne takime u informuan procesin e B.P, per qellimin, objektivat, menyren se si do te procedohet deri ne listen perfundimtare te investimeve, si edhe rreth menyres aktuale te vendim-marrjes ne lidhje me keto investime.

- Ne keto takime u qytetaret jane informuar edhe per buxhetin e bashkise si krijohet, si behet alokimi i fondeve, sa kane qene fondet per investime ne vite, etj.
- Qytetaret jane informuar per investimet qe ka kryer bashkia per vitin 2005, te ndara sipas fushave, etj.

### **Cikli i dyte Takimeve me Komunitetin**

- Ne takimet e dyta me qytetaret eshte bere perzgjedhja e prioriteteve sipas Zonave sipa kesaj procedure: Qytetaret kane propozuar te gjitha sipas mendimit te tyre per prioritetet. Pas listimit te tyre cdo pjesmarres ka patur ne dispozicion 5 vota per te votuar. Votimi u be me letra ngjitese, ku cdo pjesmarres ngjiste ne prioritetin qe ai donte te realizohej te renditur ne nje flip chart. Ne perfundim te votimit cdo zone nxirrte 3 prioritete me me shume vota, ne nje liste perfundimtare prioritetesh te renditura sipas rendesise te votuara nga pjesmarresit, te cilat do shqyrtoheshin ne Komisionin e Buxhetimit me Pjesmarrje. Nga takimet e dyta dolen 30 prioritete per te dhjete zonat.
- Ne takimet e dyta u be zgjedhja perfaqesuesve sipas zonave. Qytetaret zgjodhen nje perfaqesues me te drejte vote dhe nje tjetër si vezhgues/zevendesues, i gatshem per te marre pjese me te drejte vote ne rast mungese te perfaqesuesit te pare.

Eshte per tu theksuar qe ne te gjitha takimet e zhvilluara kane qene te ftuar te gjitha qytetaret pa perjashtuar edhe anetaret e Keshillit Bashkiak e perfaqesues te grupeve te interesit.

### **Faza e negociatave:**

- Ngritja e Komisionit te Buxhetimit me Pjesmarrje. Ky komision perbehet nga 10 perfaqesuesit te te 10 zonave te qytetit, 10 anetare jane te stafit te bashkise Elbasan dhe 4 perfaqesues te Grupeve Tematike te cilet kane punuar per Strategjine e Zhvillimit te qytetit te Elbasanit, qe te gjitha me te drejte vote. Duke e konsideruar Buxhetimin me Pjesemarrje si nje mekanizem i cili do te siguroje zbatimin e Strategjia e Zhvillimit te Qytetit pergjate viteve, duke kombinuar objektivat afatgjate me ato afatshkurter eshte e domosdoshme prania e ketyre perfaqesuesve.  
Ne Komision marrin pjese pa te drejte vote kryetaret e Komisioneve tematike te Keshillit Bashkiak, Administratoret e rajoneve te Bashkise, si edhe perfaqesuesit pa te drejte vote te zgjedhur nga qytetaret ne takimet e dyta.
- Komisioni i Buxhetimit me Pjesmarrje doli ne terren per t'u njohur me te gjitha prioritetet ne nje aktivitet te quajtur Karavan. Organizimi i Karavanit eshte i domosdoshem pasi cdo anetar i Komisionit te BP ka nevojte te njihet me te gjitha prioritetet jo vetem ne leter por duke i shkelur ne vend dhe duke mbajtur shenime per te gjykuar me vone ne lidhje me voten e tij per cdo prioritet ne mbledhjet e Komisionit.
- Negociatat dhe finalizimi i Listes se Prioriteteve per Investime u realizuan nepermjet disa kriterëve te cilat u vendosen nga vete Komisioni i BP si me poshte:

**(a) Numri i popullsisë së zonës së caktuar**

Vlerësimi i kriterit do të bëhet me pike për kategori popullsisë.

◇ Mbi 20000	banorë	7 pike
◇ 15000-20000	banorë	6 pike
◇ 13000-15000	banorë	5 pike
◇ 10000-13000	banorë	4 pike
◇ 8000-10000	banorë	3 pike
◇ 5000-8000	banorë	2 pike
◇ 3000-5000	banorë	1 pike

**(b) Numri i përfituesve si rezultat i zbatimit të projektit (kalimtare, konsumatorë, automjete)**

Vlerësimi i këtij kriteri do të bëhet me pike mbi masën e popullsisë së rrugës, rrugicës, bllokut apo pallatit që drejtperdrejt përfiton nga investimi. Vlerësimi do të bëhet nga 1 në 7 si më poshtë:

◇ Mbi 1000	përfitues	7 pike
◇ 800-1000	përfitues	6 pike
◇ 600-800	përfitues	5 pike
◇ 400-800	përfitues	4 pike
◇ 200-300	përfitues	3 pike
◇ 100-200	përfitues	2 pike
◇ Deri 100	përfitues	1 pike

**(c) Disponueshmëria e shërbimeve (sociale) dhe cilësia e tyre në zonë**

Vlerësimi i këtij kriteri do të bëhet mbi bazën e pranisë së shërbimeve sociale në zonë dhe sasisë së tyre.

◇ Prania e të gjitha shërbimeve; Shkolle të ndryshme, e mesme, qendër mjekësore, kopesht, do të vlerësohet me	0 pike.
◇ Mungesa e njerit prej shërbimeve të mësipërme me	1 pike.
◇ Mungesa e dy prej shërbimeve të mësipërme me	2 pike.
◇ Mungesa e tre prej shërbimeve të mësipërme me	3 pike.
◇ Mungesa totale e shërbimeve të mësipërme me	4 pike.

**(d) Cilësia e infrastrukturës fizike në zonë Cilësia e objekteve të lidhura (që dodhen afër) me prioritetin (psh. Rrugët dytësore me tretësore)**

1. Vlerësimi i cilësisë së rrugës/objektit të kërkuar për investime

◇ Shumë e keqe	8 pike
◇ E keqe	6 pike
◇ Disi e keqe	4 pike
◇ E pranueshme	1 pike
◇ E mirë	0 pike
◇ Shumë e mirë	0 pike

## 2. Vleresimi i infrastrukture fizike ne zone

◇ Shume e keqe	1 pike
◇ E keqe	3 pike
◇ Disi e keqe	4 pike
◇ E pranueshme	5 pike
◇ E mire	6 pike
◇ Shume e mire	7 pike

### (d) Kosto e projektit;

Duke u nisur nga rendesia e objekteve te kerkuara per investime dhe mundesite qe ka bashkia kemi menduar qe vleresimi i projekteve ne lidhje me koston e tyre te jete si me poshte:

◇ Vlera nga	5-7	milion leke	7 pike
◇ Vlera nga	4-5	milion leke	6 pike
◇ Vlera nga	7-9	milion leke	5 pike
◇ Vlera nga	2-4	milion leke	4 pike
◇ Vlera nga	1-2	milion leke	3 pike
◇ Vlera nga	9-12	milion leke	2 pike
◇ Vlera nga	deri 1	milion leke	1 pike

### (e) Perputhja me objektivat ne Strategjine e Zhvillimit te Qytetit (SZHQ);

Per te vlersuar perputhjen me objektivat strategjike te qytetit, do te marrim ne konsiderate lidhjen qe ka permiresimi i situates nepermjet investimit te kerkeses se prioritetit te dhene me objektiva konkrete te strategjise si zhvillimit qytetit dhe te zones etj. Vleresimi do te jete si me poshte:

◇ Perputhje e larte me SZHQ	7 pike
◇ Perputhje disi me SZHQ	5 pike
◇ Perputhje jo e qarte me SZHQ	3 pike
◇ Mosperputhje me SZHQ	1 pike

### Per tu realizuar ne vazhdim:

1. Mbledhje e Komisionit per ballafaqimin e planit buxhetit per investime per vitin 2006 me listen e prioriteteve te miratuar.
2. Prezantimi dhe miratimi i listes ne mbledhjen e Keshillit Bashkiak per miratimin e Buxhetit 2006.
3. Organizimi dhe ngritja e njesise se monitorimit te zbatimit te investimeve sipas listes se prioriteteve te miratuara. Njesia e monitorimit do te jete e pavarur nga Bashkia dhe do te raportoje per situaten ne Komisionin e BP.

### Vendim i Komisionit te Buxhetimit me Pjesmarrje

1. Objektet me vlere me ta madhe se 12 milion te renditen sipas pikeve te marra ne fund te listes.
2. Objekti ne Zonen nr 8, lagja 5 Maji, me emertimin sistemim asfaltim i segmentit nga lidhja me rrugen Aksioni 90, intersektimi me unazen e brendshme deri tek shkolla « Imelda Lambertini » me vlere 3 million leke, e renditur e dyta ne loisten e percaktuar ne takimin me qytetaret te zevendesojte objektin “Rehabilitim i Kopshtit prane parfumeri Sara dhe ambjenteve perreth tij”. Korrektim u be me kerkesen e qytetareve te zones.
3. Lista perfundimtare te prioriteteteve eshte:

No	Objekti	Piket	Verejtje
1	<b>Lidhja e F. Sportit me Unazen Jugore VI</b>	<b>36.35</b>	
2	<b>Riparim rruge (Godina No 2 e Bashkise), sheshi midis pallateve VII</b>	<b>35.21</b>	
3	<b>Rikonstruksion i plote i rruges ‘Jashar Ali’; uje i pijshem, KUZ, KUB dhe sistemim asfaltim V</b>	<b>34.89</b>	
4	<b>Sistemim asfaltim i segmentit nga lidhja me rrugen Aksioni 90, intersektimi me unazen e brendshme deri tek shkolla « Imelda Lambertini »</b>	<b>34</b>	
5	<b>Rehabilitim, sistemim e asfaltim i rruges nga sheshi i Pusit qe Lahet Vete deri tek rruga Ismail Zyma X</b>	<b>33.77</b>	
6	<b>Krijimi hapësirave te lira midis pallateve (tek pallati 74 dhe 44) VII</b>	<b>32.01</b>	
7	<b>Pastrimi i inerteve prane pallatit 425 dhe krijimi i ambjenteve te gjelberta IV</b>	<b>31.19</b>	
8	<b>Ndertimi i rruges kryesore; kopeshti femijeve 7 Marsi prane shkolles ‘Sul Misiri’ II</b>	<b>30.01</b>	
9	<b>Sistemim asfaltim i vazhdimit te rruges ‘Alush Saraci’ V</b>	<b>29.56</b>	
10	<b>Asfaltim i rruges dhe sheshit tek lagja ‘Clirimi’ per tek Unaza Jugore e qytetit III</b>	<b>29.1</b>	
11	<b>Sistemimi i ujrave te bardha dhe sheshit midis pallateve 129, 130, 131 dhe shtepive private II</b>	<b>28.78</b>	
12	<b>Rikonstruksion i rruges tek Porta e Kalase, nga hyrja tek bashkimi me rrugen kryesore te Kalase I</b>	<b>28.63</b>	

13	Rikonstruksioni dhe mirembajtja e varrezave ne lagjen 'Skendermbej' V	28.38	
14	Rehabilitim i rruges degezim i U se lagjes nga rruga Ismail Zyma deri ne fund ku ajo mbyllet IX	27.99	
15	Rikonstruksion i rruges nga Sigurimet Shoqerore per tek sheshi i lagjes 'Clirimi' III	27.9	
16	Bodrumet e pallatit 84 VI	27.85	
17	Sistemim asfaltim i Unazes Perendimore nga Ura e Zaranikes deri tek pika e karburantit e lagjes Partizani X	27.82	
18	Shtrimi i rruges nga pallati 46 deri tek pallati 54 VII	27.81	
19	Rekonstruksion i rruges 'Reshit Celirama' III	27	
20	Sistemim dhe asfaltim i rruges 'Kadri Gani' I	24.96	
21	Ndertimi i ambjenteve sportive dhe ruajtja me roje tek sheshi para pallatit 579/3 VIII	24.23	
22	Ndricim dhe gjelberim i rruges tek Kopshti SOROS IX	23.83	
23	Sistemim, asfaltim, KUZ, KUB i rruges 'Hamdi Roseni' X	22.36	
24	Sistemim i kanalizimeve te ujrave te zeza, rikonstruksion i linjes se ujit te pijshem ne rrugen Vasil Taja I	22.22	
25	Ndricimi i Unazes Jugore VI	34.3	16
26	Asfaltimi i shesheve brenda pallateve tek blloku 'Aksioni 90' VIII	30.16	25
27	Sistemi, asfaltim, trotuare, ndricim e gjelberim i rruges kryesore ne qender te lagjes deri tek shkallet IX	27.57	20
28	Ndertimi(rikonstruksioni) rruges 'Sul Paprri' II	27.4	16,6
29	Hapja e trotuareve e lulishteve dhe krijimi ambjenteve te gjelberta ne Unazen perendimore, nga Kryqezimi i Luleve deri tek rrethi i Zaranikes IV	27.14	15
30	Rikonstruksion i rruges nga Unaza perendimore tek Ullorja IV	22.64	13,5